

З Е Б Ф Р
А Ёё В Г д h
Ё Sh Д И Zh
Ж М Dd O Yy
С Т у Jj X
Vv Ш Ї Г Gj
Ц Ч

**A mund të e kuptojmë
njëri - tjetrin?**

Implementuar nga:



Alternative Dispute Resolution Center
Mediation Center Mitrovica

Mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Norwegian Embassy

Për publikuesin:

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC) është organizatë me bazë në rajonin e Mitrovicës puna e së cilës është e fokusuar në ndërmjetësimin e qasjes në drejtësi dhe në inkurajimin e komunikimit dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve.

ADRC ndërmjetëson rastet/lëndët e referuara nga gjykata, prokuroria dhe ato të vetë - referuara, duke intervenuar me kosto të ulët dhe kohë të shkurtër në zgjidhjen e rasteve/lëndëve që palët kanë. Bazuar në kornizën ligjore, çdo marrëveshje e arritur në procesin e ndërmjetësimit ka fuqi ekzekutive.

Krahas ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit, ADRC po ashtu kontribuon në iniciativat dhe angazhimet me të gjëra të pajtimit në mes të komuniteteve në rajonin e Mitrovicës, përmes ndërtimit të kapaciteteve njerëzore për dialog dhe negociim, dhe krijimit të hapësirave për angazhimin ndëretnik.

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë

Adresa: Rr. "Oliver Ivanović/Sami Frashëri" Nr.52, Mitrovicë, Kosovë

Kontakti: info@mediation-mitrovica.org

Website: www.mediation-mitrovica.org

Hulumtimi i Opinionit Publik

“A mund të e kuptojmë njëri - tjetrin”

Ky hulumtim i opinionit publik është realizuar në kuadër të projektit “Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë”, mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Norwegian Embassy

Përmbajtja dhe opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës së Zvicrës në Kosovë dhe të Ambasadës Mbretërore të Norvegjisë në Kosovë.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë apo mënyrë pa leje.

Përmbajtja

Rezultatet më të rëndësishme:	1
Mbi hulumtimin:	2
Përshkrimi i mostrës:.....	2
Rëndësia e gjuhës për identitetin.....	3
Perceptimi i gjuhës së “tjetrit”	7
Institucionet dhe gjuha.....	10
Si komunikojnë shqiptarët dhe serbët?.....	14
Marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve dhe perceptimi i sigurisë	23
Konkluzion:	30

Rezultatet më të rëndësishme:

37.9% e shqiptarëve të Kosovës nga Mitrovica e jugut ndjehen keq ose relativisht keq kur dëgjojnë gjuhën serbe.

40.8% e të rinjëve serb, nga mosha 16 - 25 vjeç ndjehen keq ose relativisht keq kur e dëgjojnë gjuhën shqipe.

Vetëm 13.9% e banorëve nga jugu dhe veriu i Mitrovicës e flasin gjuhën e njëri-tjetrit.

65.3% e shqiptarëve të Kosovës nga Mitrovica e jugut më të moshuar se 45 vjeç deklarojnë se e flasin gjuhën serbe.

23.70% e shqiptarëve dhe serbëve të anketuar nga jugu dhe veriu i Mitrovicës do të mësonin gjuhën e komunitetit tjetër.

64.30% e të anketuarëve shqiptarë dhe serbë nga Mitrovica e jugut dhe e veriut nuk mendojnë se gjuha serbe dhe shqipe duhet të jenë lëndë të obligueshme mësimore në shkolla.

48.70% e të anketuarëve shqiptarë dhe serb nga Mitrovica e jugut dhe e veriut e dinë se cilat janë gjuhët zyrtare në Kosovë.

Një çerek e të anketuarëve nuk e dinë se institucionet e Kosovës janë të obliguara që të përkthejnë të gjitha dokumentet në të dy gjuhët zyrtare.

Pothuajse 60% e të anketuarëve nga komunat Mitrovicë e veriut dhe e jugut nuk ndjehen të sigurt të flasin gjuhën e tyre amtare në hapësirat ku komuniteti i tyre është jo – shumicë.

52.% e të anketuarëve serbë do të pranonin të kishin për mik një shqiptar.

36% të anketuarëve shqiptarë do të pranonin të kishin për mik një serb.

55.1% të rinjëve serbë të anketuar nga Mitrovica e veriut nuk do e kishin problem të kishin për mik një shqiptar, vetëm 29.1% të rinjëve shqiptarë nga Mitrovica e jugut ndajnë të njëjtin mendim.


Mbi hulumtimin:

Hulumtimi mbi veçoritë e komunikimit ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës synon të masë nivelin ekzistues të ndërveprimit në rajonin e Mitrovicës, të ekzaminoj rolin që luan gjuha në komunikimin ndëretnik dhe të shqyrtojë pjesën e saj në polarizimin e komuniteteve dhe perservimin e identitetit etnik. Hulumtimi është realizuar si pjesë e komponentës “Sfidimi i Narrativave” të projektit “Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë”. Është i ndërtuar në kombinim të metodave cilësore dhe sasore të hulumtimit të opinionit publik.


Në periudhën ndërmjet 4 dhe 18 maj 2018, Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve ndau 1000 pyetësorë në territorin e komunave të Mitrovicës së jugut dhe të veriut. Hulumtimi u përqëndrua në perceptimin e gjuhëve serbe dhe shqipe si një ndër faktorët e ndarjes në kontekstin më të gjërë të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Grupet e synuara të hulumtimit ishin serbët dhe shqiptarët. Pyetjet kërkonin të ekzaminojnë perceptimet e komuniteteve ndaj gjuhës së tyre dhe gjuhës së "komunitetit tjetër", po ashtu dhe perceptimet mbi respektimin e të drejtave të gjuhës nga institucionet e Kosovës dhe gatishmërinë e të dy komuniteteve për të mësuar gjuhët e njëri - tjetrit. Pyetësorët që synonin të anketuarit serbë përmbanin 33 pyetje, ndërsa pyetësorët që synonin të anketuarit shqiptarë përmbanin 34 pyetje. Pjesa e dytë e hulumtimit, ajo cilësore përfshinte: 4 grupe të fokusit. Përveç kësaj, 6 intervista të shkurtra u filmuan me pjesëtarë të njohur të komunitetit serb dhe shqiptar.

Përshkrimi i mostrës:

Mosha mesatare e të anketuarve në këtë hulumtim ishte 32.79, mosha më e re 16 vjeç dhe më e vjetër ishte 82. Gjithsej 463 e të anketuarve jetojnë në komunën e Mitrovicës së jugut dhe 537 jetojnë në komunën e Mitrovicës së veriut. Shqiptarët përbëjnë 486 (48.6%) të mostrës, serbët përbëjnë 492 (49.2%) dhe 22 (2.2%) e të anketuarve u takojnë grupeve të tjera etnike. Gjithsej 493 (49.3%) e të anketuarve ishin gra, 480 (48%) ishin burra dhe 24 (2.4%) nuk specifikuan seksin e tyre. Shumica e pjesëmarrësve (43.9%) kanë të përfunduar shkollimin e mesëm.



Një e treta e të anketuarve është e punësuar.



Rëndësia e gjuhës për identitetin


Gjuha amtare thuhet të jetë element veçanërisht i rëndësishëm i identitetit etnik (Fishman, 1991). Gjuha, është deklaruar, përbën një shënues të kategorive më të mëdha sociale, të tilla si kombi

(Windisch, 2004). Narrativat e këtyre kombeve janë, ndër të tjera, të përcaktuara dhe të përfaqësuara nga gjuha në përdorim. Në këtë kuptim, gjuha është produkt i mendimit dhe sjelljes së një shoqërie. Megjithatë, dhe e kundërta është e vërtetë: gjuha gjithashtu mund të përcaktojë strukturat shoqërore dhe të influencojë sjellje brenda këtyre strukturave. Kjo është pikëpamja që qëndron pas hipotezës Whorfian-e. Prandaj mund të argumentohet se gjuha dhe shoqëria ndikojnë tek njëra - tjetra përmes bashkëjetesës dhe varësisë nga njëra - tjetra.


Këto teori përjetohen dhe në hapësirën gjeografike të cilën e mbulon ky hulumtim. Për të dy bashkësitë shqiptare dhe atë serbe të Kosovës, gjuha luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e identiteteve të tyre dhe të sjelljes ndaj njëri-tjetrit. Gjuha shqipe dhe ajo serbe kanë nuanca linguistike, nuanca që i mveshin dhe një shtresë debateve brenda dhe atyre ndërmjet komuniteteve.

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore, gegë dhe tosk. Në jetën zyrtare, shqiptarët e Kosovës përdorin gjuhën standarde të dominuar nga dialekti tosk dhe një pothuajse kombinim të gjuhës standarde dhe dialektit gegë në ndërveprimet e tyre private. Serbët përdorin dy alfabetë të ndryshme, cirilik dhe latin. Megjithëse të përdorura zyrtarisht dhe në mënyrë të barabartë, alfabeti cirilik ndahet nga serbët dhe popujt sllavë si maqedonasit, bullgarët dhe rusët, dhe konsiderohet të jetë më tradicional.


Si pjesë e këtij hulumtimi, pjesëtarëve të komunitetit shqiptar iu kërkua të shqyrtojnë po ashtu marrëdhënien me gjuhën e tyre dhe dy dialektet kryesore të saj: gegë dhe tosk. Më shumë se një e treta e të anketuarve shqiptarë deklaruan se dialekti gegë është shumë i rëndësishëm për identitetin e tyre. Në shkallë prej 1 deri në 5, rëndësia e dialektit gegë për identitetin shqiptar të Kosovës në Mitrovicë, arrin mesataren prej 3.35.




Një nga pyetjet që iu parashtrua të anketuarve shqiptarë të Kosovës ishte nëse ato do të dëshironin që dialekti gegë i gjuhës shqipe të ketë përdorim në formë zyrtare në Kosovë. Mendimet e qytetarëve shqiptarë të Mitrovicës së veriut dhe jugut janë shumë të ndara. Një numër pothuajse i barabartë i të anketuarve dëshirojnë që gjuha standarde e dominuar nga dialekti tosk të qëndrojë në përdorim zyrtar (182) dhe që dialekti gegë të ketë përdorim zyrtar (182). Të anketuarit e tjerë (126) deklaruan se nuk kanë opinion sa i përket kësaj çështje.



Komuniteti serb është më pak i ndarë kur është fjala për rëndësinë e njërës nga alfabetet për identitetin e tyre, me shumicën dërrmuese (64.5%) që e konsiderojnë alfabetin cirilik si më të rëndësishëm për identitetin e tyre sesa alfabeti latin.



Në përputhje me këto rezultate, të anketuarit serbë (46.70%) kryesisht deklarojnë se ndjehen mirë ose shumë mirë kur shohin se institucionet e Kosovës përdorin alfabetin cirilik. Kur elaborojnë se pse ndjehen në këtë mënyrë, pjesa më e madhe e atyre që përjetojnë ndjenjë pozitive thonë se kjo shënon respekt për gjuhën serbe. Ndërsa ato që kanë ndjenjë neutrale, shpjegojnë se alfabeti nuk është i rëndësishëm aq sa do ishte korrektësia e gjuhës, apo thjesht nuk kanë interes në atë që institucionet e Kosovës bëjnë, sepse nuk i ndjejnë si të tyre. Ato pohojnë se cilësia e përkthimit të dokumenteve zyrtare duhet të jetë më e mirë. Së fundmi, të anketuarit të cilët deklarojnë se kanë ndjenja negative kur shohin institucionet e Kosovës duke përdorur alfabetin cirilik, pretendojnë se kjo nuk është praktika ose e shohin si përvetësim të identitetit serb.



Perceptimi i gjuhës së "tjetrit"


Marrëdhëniet shqiptaro-serbe janë ndër marrëdhëniet më të tensionuara në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe komunat e Mitrovicës së veriut dhe asaj të jugut janë epiqendra e këtyre marrëdhënieve. Dy komunat dikur ishin pjesë e një qyteti që u nda përgjatë vijës së lumit Ibër në fillim të vitit 2000. Lumi përfaqësonte vijën e ndarjes fizike, etnike dhe politike, dhe të njëjtin rol vazhdon të ketë dhe sot. Vetëm një përqindje e vogël e shqiptarëve të Kosovës kanë mbetur për të jetuar në komunën veriore, ndërsa nuk ka serb të Kosovës që jetojnë në komunën jugore, përveç në fshatrat e "diskutueshme" në kufirin administrativ të komunave.

Përveçse shumë të ndryshme, gjuha shqipe dhe ajo serbe perceptohen dhe si mjete të dominimit. Hulumtimi kualitativ ka treguar se të dy komunitetet e lidhin aktin e mësimit të gjuhës tjetër si një akt nënshtrimi ose dhënie ndaj komunitetit tjetër. Madje, disa nga respondentët shqiptarë në grupet e fokusit e përshkruan aktin e mësimit të gjuhës serbe si "ri - okupim" dhe "heqje dorë nga pjesë të sovranitetit".

Nga ana tjetër, respondentët serbë në grupet e fokusit, deklaruan se kur dëgjojnë gjuhën shqipe ndiejnë frustrim për shkak se nuk e kuptojnë se çfarë thuhet. Të tjerë gjithashtu e lidhën atë me ndjenjën e shqetësimit dhe të mos - sigurisë, veçanërisht pas luftës. Tani, ndërsa niveli i ndërveprimit po rritet, pothuajse gjysma e respondentëve serbë, pjesë e grupeve të fokusit thonë se për ato që planifikojnë të qëndrojnë në Kosovë, të mësuarit e gjuhës shqipe do bëhet e domosdoshme.

Një nga respondentët më të vjetër serb rikujtoi kohën kur gjuha shqipe mësohej në shkollë dhe u shpreh se mësimi i institucionalizuar nuk ishte kurrë shumë i suksesshëm, pasi as fëmijët, as prindërit dhe mësuesit nuk e morën atë si një gjë domosdoshmërisht të rëndësishme. Të mësuarit e gjuhës shqipe ishte më shumë formalitet, deklaroi respondentë. Vazhdoi duke thënë se vetëm ato që kishin kontakte të rregullta me shqiptarët e njihnin mirë gjuhën shqipe. Respondenti në fjalë gjithashtu deklaroi se në epokën jugosllave, nëpunësit civilë që njihnin të dyja gjuhët përfitonin shtesë në pagat e tyre për të shërbyer si shembull tek nëpunësit tjerë për të mësuar të dyja gjuhët.

Ndërsa shumica e ish-fqinjëve ndihen neutral kur dëgjojnë gjuhën e komunitetit tjetër, përqindjet e atyre që kanë ndjenja negative janë ende alarmante dhe në rastin e shqiptarëve të Kosovës arrijnë mbi një të tretën e të anketuarve (37.90%). Kur bëhet klasifikimi sipas moshave, të rinjtë serbë, të moshës 16-25 vjeç, shënojnë edhe më shumë me 40.8% të deklarimeve se ndihen keq ose relativisht keq kur dëgjojnë gjuhën shqipe. Më tolerantë ndaj gjuhës së komunitetit tjetër janë ato mbi 46 vjeç (71% e shqiptarëve dhe 66% e serbëve) që kanë përjetuar jetën e përbashkët. Gratë e të dy grupeve etnike janë pak më shumë tolerante se burrat.



Gjatë mbledhjes së të dhënave, si në aspektin cilësor ashtu dhe në atë sasior të hulumtimit, të dy grupet etnike shpesh përdorin sintagmën "gjuha e armikut" ose justifikojnë nevojën për të mësuar

gjuhën e tjetrit duke pohuar se juve duhet të njihni gjuhën e armikut tuaj në mënyrë që të jeni në gjendje t'a kuptoni atë.

Si ilustrim, një i intervistuar shqiptar tha se do të mësonte gjuhën serbe, por se nuk do t'a fliste atë. "Nëse personi pranë e di gjuhën angleze, atëherë ne mund të shkëmbejmë në këtë gjuhë. Nëse jo, atëherë unë nuk do të zhvilloja bisedë në gjuhën serbe", u shpreh i intervistuari. Një tjetër i intervistuar i komunitetit shqiptar shpjegoi se ekzistojnë narrativa që portretizojnë serbët si "demonë dhe krijesa të dhunshme", që sipas të intervistuarit është koncept që ekziston në të dy komunitetet.

Tabela në vijim tregon segregimin e përgjigjeve sipas përkatësisë etnike dhe grupmoshave.

		Keq	Relativisht keq	Neutral	Mirë	Shkëlqyeshëm
16-25	Shqiptar	33.3%	4.1%	58.5%	1.2%	2.9%
	Serb	20.1%	20.7%	49.5%	4.9%	4.9%
26-45	Shqiptar	36.2%	5.1%	51.5%	2.6%	4.7%
	Serb	16.4%	8.5%	59.2%	9.5%	6.5%
46-90	Shqiptar	26.8%	0%	71%	0%	1.4%
	Serb	13.4%	4.1%	66%	4.1%	12.4%


Perceptimi i alfabetit cirilik nga ana e komunitetit shqiptar është i ngjashëm me perceptimin e gjuhës serbe në përgjithësi, me 57.7% e të anketuarve shqiptarë që deklarojnë se ndihen neutral ndaj faktit se disa institucione të Kosovës përdorin alfabetin cirilik, përderisa 37.7% kanë ndjenja negative ose shumë negative për këtë gjë.

Të anketuarve shqiptarë, pjesë e grupeve të fokusit u kërkua që të provojnë të shpjegojnë burimin e negativitetit ndaj alfabetit cirilik. Përderisa disa të anketuar ofruan shpjegimin e përgjithshëm se rrënjët e shqetësimit në raport me këtë alfabet mund të gjenden në "historinë më të re", të tjerët kishin perceptim dhe më negativ të alfabetit cirilik, duke e përcaktuar atë madje si një "element nacionalist".

Si shembull, një nga pjesëmarrësit deklaroi se në vitet '80, duke përdorur "cirilik dhe simbole tjera nacionaliste, sistemi i atëhershëm u përpoq t'i thellonte dallimet". Ky i anketuar beson se qëllimi i gjuhës është të mundësojë komunikimin dhe të lidhë njerëzit, prandaj duhet të mbahet i thjeshtë. Ai

gjithashtu ndau mendimin se përdorimi i alfabetit cirilik në vitet '80 ishte përpjekje për të ngritur komunitetin serb në Kosovë mbi të tjerët.


Një tjetër respondent deklaroi se ndonëse nuk përmban sentimente negative ndaj vetë gjuhës serbe, e pranon alfabetin cirilik si "agresiv", si diçka që i rikujton përvojat e pakëndshme të viteve '98 dhe '99.




Institucionet dhe gjuha

Gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë, me të drejta të barabarta. Sidoqoftë, folësit e gjuhës serbe hasin në vështirësi në baza ditore gjatë përdorimit të gjuhës së tyre në institucionet e Kosovës, ku cilësia e dobët e përkthimit të ligjeve dhe dokumenteve zyrtare është mirë e dokumentuar. Cilësia e përkthimit të dokumenteve në gjuhën serbe është shpesh aq e varfër sa që folësit e kësaj të fundit i drejtohen gjuhës angleze për leximin e ligjeve dhe dokumenteve tjera zyrtare. Prandaj, ekziston një bindje në mesin e komuniteteve se gjuha angleze është gjuha e tretë zyrtare në Kosovë. Në fakt, pothuajse një e treta e të anketuarve ndajnë këtë mendim (32.2% e serbëve dhe 25.5% e shqiptarëve). Një përqindje më e lartë e shqiptarëve (55.8%) sesa serbët (42.2%) janë të njohur se gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë dy gjuhët zyrtare në Kosovë. Niveli i atyre që kanë dhënë përgjigje të saktë shënoi progres me rritjen e nivelit të arsimimit në secilin grup etnik. Të rinjtë (16-


25) serbë janë më së paku të informuar me vetëm 35.6% që janë përgjigjur në mënyrë të saktë në atë se cilat janë gjuhët zyrtare në Kosovë.




Pyetjet ishit të dizajnuara që gjithashtu të ekzaminojnë të kuptuarit e njerëzve mbi statusin e gjuhëve zyrtare në Kosovë. Është interesante se një e katërta e të anketuarve nuk janë të njohur se institucionet janë të detyruara të përkthejnë të gjitha dokumentet në të dy gjuhët zyrtare.




Të anketuarit u pyetën dhe për perceptimet e tyre në raport me nivelin e respektimit të gjuhës shqipe në hapësirat me shumicë serbe dhe respektimin e gjuhës serbe nga institucionet e Kosovës. Ato ishin të prezantuar me një shkallë prej 1 deri në 5 dhe i'u kërkua të vlerësonin respektimin e gjuhëve zyrtare nga shkalla më e ulët deri në të shkëlqyer. Respektimi i gjuhës shqipe në hapësirat me shumicë serbe u vlerësua me një nivel mesatar prej 2.76, ndërsa respektimi i gjuhës serbe nga institucionet e Kosovës u vlerësua me shkallë 3.13. Perceptimet e "komuniteteve të kundërta" janë dukshëm të ndryshme, me serbët që vlerësojnë respektimin e gjuhës serbe nga institucionet e Kosovës me 2.44 dhe respektimin e gjuhës shqipe në hapësirat me shumicë serbe me 2.9. Shqiptarët e përcaktojnë respektimin e gjuhës serbe me një shkallë prej 3.8 dhe e vlerësojnë respektimin e gjuhës shqipe në hapësirat me shumicë serbe me 2.5.



Përderisa perceptimet sugjerojnë se të dy grupet etnike mendojnë se të drejtat e tyre gjuhësore janë të kërcënuara, përvoja praktike tregon se folësit e gjuhës serbe përjetojnë më shumë vështirësi në bashkëveprimin e tyre me institucionet. Një e katërta e të anketuarve serbë deklaruan se kanë pasur vështirësi në përdorimin e gjuhës amtare në institucionet e Kosovës.




Hulumtimi tregon se 60% e të anketuarve serbë nuk i përdorin faqet e internetit për të marrë informacione mbi institucionet e Kosovës. Kjo e gjetur qëndron në linjë me perceptimin se shumica e faqeve zyrtare të institucioneve të Kosovës kanë cilësi të dobët të përkthimit dhe shpesh nuk kanë përkthim fare.



Si komunikojnë shqiptarët dhe serbët?

Në përgjithësi, marrëdhëniet ndëretnike në mes të banorëve të veriut dhe jugut të Mitrovicës janë të tendosura dhe jo aq frekvente sa ndoshta mund të pritët nga komunitete që jetojnë aq afër. Diku rreth një e treta e të anketuarve kanë deklaruar se nuk komunikojnë kurrë me pjesëtarë të komunitetit tjetër. Shkalla e atyre që nuk ndërveprojnë me komunitetin tjetër është shumë më e lartë ndër të anketuarit shqiptarë (50.4%) sesa ndër të anketuarit serbë (20.1%), që është e kuptueshme duke pasur në mendje se Mitrovica e veriut ka disa lagje multietnike. Sa i përket atyre që komunikojnë në baza ditore me komunitetin tjetër¹, shkalla më e lartë regjistrohet me serbët e Kosovës së moshave 26 deri më 45 (16.9%). Ndërveprimi më i lartë i raportuar me serb observohet ndër komunitetin shqiptar të së njëjtës moshë (6.4%). Megjithatë, shqiptarët në këtë grupmoshë ruajnë po ashtu përqindjen më të lartë të të anketuarve që cilët deklarojnë se nuk kanë ndërveprim me komunitetin serb (58.1%). Nga ana tjetër, në mesin e të anketuarve serbë është grupmosha 16-25 vjeç që arrin përqindjen më të lartë të atyre që nuk komunikojnë fare me shqiptarët (26.1%). Së fundi, burrat në të dy grupet etnike komunikojnë më shpesh se gratë. Burrat serb komunikojnë me shqiptarët dy herë më shumë se gratë serbe.

¹ Pyetja drejtuar komunitetit serb të Kosovës ishte: "Sa shpesh komunikoni me pjesëtarë të komunitetit shqiptar", ndërsa pyetja drejtuar komunitetit shqiptar ishte: "Sa shpesh komunikoni me pjesëtarë të komunitetit serb".




Rezultatet e përgjigjeve të të anketuarve në pyetjen se sa shpesh komunikojnë me serb/shqiptar janë filtruara sipas grupit etnik dhe moshës.

Mosha	Grupi etnik	Çdo ditë	Së paku një herë në javë	Një herë në muaj	Disa herë gjatë vitit	Asnjëherë
16-25	Shqiptar	4.6%	5.8%	4.6%	42.2%	42.8%
	Serb	4.8%	14.4%	20.2%	34.6%	26.1%
26-45	Shqiptar	4.2%	6.4%	5.1%	26.3%	58.1%
	Serb	16.9%	24.9%	20.9%	20.9%	16.4%
46-90	Shqiptar	2.7%	5.4%	2.7%	45.9%	43.2%
	Serb	16.5%	15.5%	23.7%	29.9%	14.4%

Ndaras frekuencës së kontaktit, komunikimi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve shpesh pengohet nga gjuhët e tyre amtare, të cilat janë shumë të ndryshme dhe nuk kanë qenë pjesë e kurrikulave të dy komuniteteve për më shumë se 27 vite. Në fakt, në këto dy komuna fqinje, vetëm 13.9% e të

anketuarve flasin gjuhët e njëri-tjetrit². Në kuadër të të dy grupeve etnike, janë të anketuarit më të moshuar se 45 vjeç që e njohin gjuhën e grupit tjetër etnik. Megjithatë, një përqindje shumë më e lartë e shqiptarëve të Kosovës, më të moshuar se 45 (65.3%) sesa serbët e Kosovës të të njëjtës grupmoshë (13.4%) flasin gjuhën e komunitetit tjetër. Kur bëhet fjalë për të anketuarit serbë ndërmjet 46 dhe 90 vjeç, 14.4% e tyre thonë se e kanë ditur, por e kanë harruar gjuhën shqipe.




Rezultatet që tregojnë se një përqindje më e lartë e shqiptarëve të Kosovës e flasin gjuhën serbe nuk janë befasuese, pasi shqiptarët e Kosovës ishin jo - shumicë në kohën jugosllave dhe kanë qenë të rrethuar nga popujt që e kanë folur gjuhën sot të njohur si gjuha boshnjake – kroate – malazeze - serbe (BKMS). Mendohet se janë diku rreth 21 milionë folës amtari të gjuhës - BKMS³. Kjo gjuhë është gjithashtu disi e ngjashme me gjuhën fqinje maqedonase dhe në një masë më të vogël me gjuhën bullgare dhe atë ruse.

² Pyetja drejtuar komunitetit serb ishte: “A e flisni gjuhën shqipe?”, ndërsa pyetja drejtuar komunitetit shqiptar ishte: “A e flisni gjuhën serbe?”

³ Kjo është gjuhë që ka status zyrtar në Kroaci, Bosnje, Malin e Zi, Serbi, Kosovë dhe BE.


Kur komunikoni me serb/shqiptar, cilat gjuhë përdorni?



Gjuha angleze është mjet i komunikimit me të cilën shërbehën serbët dhe shqiptarët për të krijuar komunikim, kjo është veçanërisht e vërtetë për gjeneratat më të reja.

Është interesante se shumica e të anketuarve nuk mendojnë se fakti që komuniteti shqiptar dhe ai serb nuk flasin gjuhët e njëri-tjetrit i pengon ato që të kuptojnë pozitën e komunitetit tjetër. Për fat të keq, është ndoshta pikërisht kjo bindje që përforcon stereotipet që komunitetet kanë ndaj njëri - tjetrit.


A mendoni se fakti që serbët dhe shqiptarët flasin gjuhë të ndryshme i pengon të kuptojnë plotësisht pozitën e komunitetit tjetër?



■ Po ■ Jo, ne e kuptojmë njëri - tjetrin mjaft mirë ■ Nuk e di

Është e mundshme që përdorimi i gjuhëve zyrtare në komunikimin ndërmjet komuniteteve të rritet në të ardhmen, pasi pothuajse një çerek e të anketuarëve tanë deklaruan se do të mësonin gjuhën shqipe apo serbe⁴.


A do të mësonit gjuhën shqipe/serbe?



■ Po ■ Jo ■ Nuk e di ■ E di/njoh gjuhën shqipe/serbe

⁴ Të anketuarit serbë u pyetën nëse do të mësonin gjuhën shqipe dhe të anketuarit shqiptarë u pyetën nëse do të mësonin gjuhën serbe.

Është inkurajues fakti se përqindja e atyre që janë të gatshëm të mësojnë gjuhën e komunitetit tjetër nuk shënon zbritje ndër të anketuarit e rinj. Përkundrazi, 31% e të anketuarve shqiptarë të moshës 16 deri 25 vjeç janë të interesuar të mësojnë gjuhën serbe, përqindja e të anketuarve serbë të së njëjtës grupmoshë është 22.9%. Shpërndarja është e kundërt në grupmoshën ndërmjet 26 dhe 45 vjeç, 30% e të anketuarve serbë do të mësonin gjuhën shqipe dhe 22% e të anketuarve shqiptarë do të mësonin gjuhën serbe. Përqindja më e lartë e respondentëve të pavendosur (21.9%) identifikohet në mesin e të anketuarve serbë të moshës 46-90 vjeç. Ndër pjesëtarë të këtij grupi që ka interpretuar këtë përqindje u shpreh se është vonë për të mësuar gjuhë në këtë moshë.




Të anketuarit shqiptarë në grupe të fokusit kryesisht pajtohen me atë se personi që vendos të mësojë gjuhën e komunitetit tjetër do të gjykohej nga shumica e pjesëtarëve të komunitetit që i takon, se nuk do të ishin nën presion për të ndaluar mësimin e gjuhës, por nuk do të ishte e lehtë për të pranuar publikisht se po mësojnë gjuhën e komunitetit tjetër.

Të anketuarit serbë ndajnë mendimin se do të ekzistonte një nivel i stigmatizimit pasi shumë pjesëtarë të komunitetit serb nuk e pëlqejnë gjuhën shqipe, duke besuar se ka një korpus më të varfër të fjalëve. Nga ana tjetër, ato deklaruan se presin që niveli i stigmatizimit në komunitetin shqiptar të


jetë më i lartë, për shkak të "frustrimit dhe faktit që shqiptarët mendojnë se serbët mendojnë që janë më të mirë".

Të tjerë u shprehën se niveli ose stigmatizimi mund të jetë më i lartë për shkak të mospëlqimit të skajshëm të shkronjave cirilike dhe faktit se shqiptarët duhej të dinin gjuhën serbe në shtetin e mëparshëm dhe për këtë arsye, mësimi i gjuhës serbe tani mund të përceptohet si shtypja që shqiptarët ndjejnë se e kanë përjetuar në të kaluarën.

Shkalla e atyre që do të mësonin gjuhën e komunitetit tjetër korrespondon me shkallën e njerëzve që mendojnë se jeta e tyre do të ishte më e lehtë ose shumë më e lehtë nëse do të dinin gjuhën e komunitetit tjetër.



Megjithatë, përqindjet e paraqitura më lartë janë premtuese vetëm sa i përket edukimit jo - formal, pasi situata është dukshëm ndryshe kur bëhet fjalë për prezantimin e mësimin të gjuhës shqipe dhe serbe në shkollë. Mbi 60% e të anketuarve nga të dy grupet etnike nuk mendojnë se gjuhët zyrtare duhet të mësohen në shkollë. Dallimet në opinionet ndërmjet dy grupeve etnike dhe të gjitha grupmoshave variojnë vetëm pak.



Megjithatë, pjesëmarrësit në grupet e fokusit vunë në pah shumë përparësi që lidhen me njohjen e gjuhës së komunitetit tjetër. Një ndër përparësitë e përmendura ishte ajo se e rrisë konkurrencën e në tregun e punës.

Disa nga pjesëmarrësit e grupeve të fokusit që ishin më fleksibil në raport me këtë temë, theksuan se nëse këto dy gjuhë do të prezantoheshin në shkolla, lënda mësimore do të duhej të ishte fillimisht zgjedhore, si mënyrë për të shmangur çfarëdo reagimi negativ nga komunitetet. Një tjetër pjesëmarrës propozoi transmetimin më të shumtë të përmbajtjes në gjuhën serbe për të pasur kështu një ambientim më të relaksuar të gjuhës serbe tek komuniteti shqiptar dhe zvogëlim të animoziteteve.

Një ndër pjesëmarrësit serb në grupet e fokusit deklaroi se narrativat antagoniste ndajnë komunitetet në të gjitha aspektet, duke sjell kështu kontaktin në nivele minimale, komunitetet ndërveprojnë vetëm nëse është shumë e nevojshme. Në këtë realitet, njerëzit nuk mund të shohin as nevojën e as përparësitë e komunikimit më të mirëfilltë.

Një pjesëtar i komunitetit shqiptar i pranishëm në grupet e fokusit u shpreh se gjuha serbe duhet të jetë lëndë e obligueshme në shkolla pasi vetëm se është gjuhë zyrtare në Kosovë, përfshirja e saj në shkolla do të ishte një ndër mekanizmat e implementimit të kornizës aktuale ligjore mbi gjuhët.


Disa pjesëmarrës tjerë shqiptarë theksuan se duke qenë të rrethuar nga vende në të cilat për komunikim përdoret gjuha serbo-kroate-boshnjake, mësimi i këtyre gjuhëve mund të jetë përparësi në mobilitet, bërje të biznesit në rajon apo në shfrytëzimin e literaturës së kësaj gjuhe.

Në pyetjen mbi benefitet e mësimi të gjuhës shqipe, pjesëmarrësit serbë në grupe të fokusit kryesisht ofruan shembuj të tillë si: komunikim më i lehtë me shërbyesit civilë, mundësi më të mëdha në tregun e punës por dhe një ndjenjë sigurie. Disa ndjejnë se do të ishte më e sigurt nëse do njihnin gjuhën shqipe. Një nga pjesëmarrësit tha se njohja e gjuhës së tjetrit është mjet i fuqishëm i dominimit përmes përfshirjes. Pjesëmarrësi në fjalë, vazhdoi duke shpjeguar se adresimi personit tjetër në gjuhën e tyre amtare nuk është vetëm çështje respekti, por dhe krenarie e dominimi, “sikur ju i keni pushtuar kulturën e personit përballë, sikur e njihni më mirë sesa në rast se kur do të komunikoni në një gjuhë të tretë”.

Një ndër respondentët shqiptar u shpreh madje se do të studionin filozofi në Mitrovicën e veriut nëse do të njihnin gjuhën serbe dhe se nuk do ishte fakt brengosës se kemi të bëjmë me universitet të shtetit serb. Për të kjo do ishte një zgjidhje praktike pasi ky universitet gjendet më afër vendbanimit që kanë.

As respondentët serbë dhe as shqiptarë nuk duket se janë të interesuar në realitetet e njëri – tjetrit, që bëhet dhe më e qartë në bazë të mungesës së interesit për të ndjekur mediat që raportojnë në gjuhën e komunitetit tjetër. Pothuajse 80% e tyre nuk janë të interesuar të ndjekin se çfarë thuhet nga mediat që raportojnë në gjuhën tjetër, por diku 20% do të lexonin këto të fundit nëse do ishin të përkthyer në gjuhën e tyre.


A i ndjekni mediat në gjuhën shqipe/serbe?




Pjesëmarrësit serbë në grupin e fokusit thanë se konsultojnë mediat shqip-folëse për perspektivë, duke shpjeguar se e vërteta është gjithmonë në gjysmë të rrugës mes asaj që mediat e Serbisë dhe ato të Kosovës raportojnë.

Marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve dhe perceptimi i sigurisë

Në përgjithësi, të anketuarit nuk ndihen të sigurt të flasin gjuhën e tyre në zonat ku komuniteti i tyre është jo – shumicë.




Të anketuarve të cilët deklaruan se ndjenja e tyre e sigurisë kur flasin gjuhën amtare në hapësirat ku komuniteti i tyre është jo - shumicë varet nga zona ku gjenden, i'u kërkua të emërojnë disa komuna në Kosovë ku do të ndiheshin të sigurt dhe disa komuna në Kosovë ku nuk do të ndiheshin të sigurt të flisnin gjuhën e tyre. Të anketuarve shqiptarë i'u kërkua të emërojnë hapësirat me shumicë serbe dhe të anketuarve serbë i'u kërkua që të emërojnë hapësirat me shumicë shqiptare. Jo të gjithë të anketuarit kuptuan detyrat dhe vetëm ato që ofruan përgjigje në përputhje me udhëzimet janë marrë në konsideratë. Është e rëndësishme të theksohet se pyetja ishte e hapur, që do të thotë se të anketuarve nuk ju ofruan sugjerime, por i'u kërkua të shkruanin përgjigjet e tyre. Kur është fjala për të anketuarit serbë, mbi një e treta e atyre që emëruan një komunë ku do të ndiheshin të pasigurt për të folur gjuhën serbe (126) përmendën Mitrovicën e jugut si zonë të pasigurt (50). Tabela e mëposhtme posedon shpërndarjen e përgjigjeve të të anketuarve serbë.




Në anën tjetër, vendi se ku serbët e Kosovës do të ndiheshin më të relaksuar që të flasin gjuhën serbe është Prishtina.

Ju lutem tregoni se në cilën komunë me shumicë shqiptare do të ndiheshit të sigurt që të flisni gjuhën serbe?




Kur i referohemi të anketuarëve shqiptarë, nga 141 të anketuar që kanë specifikuar një hapësirë me shumicë serbe ku do ndiheshin të sigurt që të flasin gjuhën shqipe, 41% janë shprehur se do të ndiheshin të sigurt në komunat me shumicë serbe në jug të vendit, si Graçanicë, Partesh, Çagllavicë. Pjesa tjetër do të ndjehej e pasigurt në veri të Mitrovicës (44%), Leposaviç (10%) dhe Beograd dhe Preshevë (0.2% secila).

Vlen të përmendet se një nivel i konsiderueshëm i të anketuarve do të ndihej më sigurt të përdorin gjuhën e tyre në hapësirat ku komuniteti i tyre është jo – shumicë nëse do ishin të shoqëruar nga një pjesëtar i komunitetit shumicë.



Në mënyrë që të përcaktohet kuantiteti i marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, të anketuarve i'u prezantua një shkallë e distancës etnike. Shkalla ishte e përbërë nga tetë pyetje të ndryshme që lidhen me llojet e ndërveprimit shoqëror me pjesëtarët e komunitetit tjetër (serb ose shqiptar). Të anketuarit të cilët nuk kundërshtuan asnjë lloj ndërveprimi (dhe kështu shënuan 0 nga 8 në shkallë) janë ato që nuk kanë distancë etnike. Ato që kundërshtojnë deri në 3 lloje të ndërveprimeve janë disi më të largët, ato që shënuan deri në 6 janë në distancë të moderuar dhe të anketuarit që shënuan shkallën deri në 8 janë shumë distant.



Lloji më i pranueshëm i ndërveprimit tek të anketuarit është që të kenë pjesëtarë të komunitetit tjetër të jetojnë në të njëjtin qytet si i anketuari (619 nga 998 ose 62% e të anketuarve nuk kanë pengesa me këtë lloj ndërveprimi). Lloji më i kundërshtuar i ndërveprimit shoqëror është të kenë një person nga komuniteti tjetër si bashkëshort/e apo dhëndër/nuse.

A do të pranoni që një pjesëtar i komunitetit shqiptar/serb	Nr. i të anketuarve që janë përgjigjur me "JO"	Gjithsej numri i të anketuarve
Të jetojë përgjithmonë në qytetin tuaj	379 (37.97%)	998
Të kthehet që të jetojë në pjesën tuaj të qytetit	425 (42.67%)	996
Të jetojë në lagjen tuaj	529 (53.16%)	995
Të ketë pozitë të lartë në qeveri	730 (73.44%)	994
Të jetë mbikqyrës/e juaj në vendin e punës	747 (75.23%)	993
Të bëhet mik/e juaj	545 (54.99%)	991
Të bëhet dhëndër apo nuse juaj	903 (90.48%)	998
Të bëhet bashkëshort/e juaj	901 (90.55%)	995

Dallimet më të theksuara të përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit serbë dhe ata shqiptarë vërehen në tre ndërveprimet e fundit që i takojnë më tepër rrafshit personal, miqësor, familjar dhe bashkëshortor. Nëse flasim në mënyrë më relative, të anketuarit serbë janë disi më tolerant se të anketuarit shqiptarë në këtë aspekt. Të rinjtë e të dy grupeve etnike janë më të largët ndër të anketuar. Të rinjtë shqiptarë (16 – 25) kanë shkallën më të ulët të pranimin në 7/8 ndërveprime. I vetmi ndërveprim në të cilin pjesëtarët e komunitetit serb të së njëjtës moshë kanë nivelin më të ulët të pranimin është ai "të kenë pjesëtarë të komunitetit tjetër si mbikqyrës/e në punë" (19% të të anketuarve serbë kundrejt 24% e të anketuarve shqiptarë). Grupi më tolerant është ai i grupeve etnike më të moshuar se 45 vjeç.




Tabela në vijim pasqyron përqindjet e përgjigjeve pozitive të kryq - referencuara dhe me grupmoshat dhe me grupin etnik:

	16-25		26-45		46-90	
	Serb	Shqiptar	Serb	Shqiptar	Serb	Shqiptar
Të jetojë përgjithmonë në qytetin tuaj	61.7%	48.9%	64%	64.4%	62.9%	70.7%
Të kthehet që të jetojë në pjesën tuaj të qytetit	52.7%	51.1%	53.5%	62.1%	57.3%	69.3%
Të jetojë në lagjen tuaj	46.2%	37.9%	43.5%	46.8%	49.5%	60%
Të ketë pozitë të lartë në qeveri	24.6%	20.1%	29.6%	20.9%	36.5%	32%
Të jetë mbikqyrës/e juaj në vendin e punës	19.4%	24.1%	26.1%	21.6%	24.6%	23.7%
Të bëhet mik/e juaj	55.1%	29.1%	49.7%	37.7%	54.2%	46.7%
Të bëhet dhëndër apo nuse juaj	11.2%	4%	15%	3%	15.5%	6.7%
Të bëhet bashkëshort/e juaj	7%	6.9%	14%	5%	14.4%	6.7%

Një nga pjesëmarrësit shqiptar në grupin e fokusit shpjegoi ndryshimin e observuar në përqindjen e njerëzve që do të kishin dëshirë të kishin një mik/e nga komuniteti tjetër, pasi një nivel më i lartë i serbëve nuk do e kishin problem të kishin një pjesëtar të komunitetit shqiptar për mik/e. Ky pjesëmarrës tha se rezultatet do të kishin qenë anasjelltas në të kaluarën, sepse më shumë shqiptarë do ishin të vullnetshëm të vendosnin komunikim me serbët. Respondenti në fjalë e lidhte këtë me kontrollin e sistemit, të institucioneve që ishin të drejtuara nga "serbët". Siç elaboron, shqiptarët e udhëheqin tani sistemin dhe serbët janë më proaktivë, për sa i përket ndërveprimit me shqiptarë.

Një tjetër respondent nga komuniteti shqiptar insistoi se Mitrovica duhet të shikohet si një vend unik, ku konflikti është ende i ngrirë, shoqëritë janë ende të mbyllura dhe manipulohen lehtë nga politika. Kështu, ky pjesëmarrës këmbëngul se regjioni i Mitrovicës është instrumentalizuar nga politika, gjë që reflektohet në të gjeturat e këtij hulumtimi. Është i mendimit se këto të fundit do ishin të ndryshme nëse përgjigja do të kërkohej në Prishtinë apo Beograd.

Pjesëmarrësit serbë në grupet e fokusit u pajtuan në masë të madhe. Jo vetëm që konflikti në Mitrovicë është ende shumë i prekshëm, por Mitrovica është e vetmja zonë e dikurshme urbane multietnike në Kosovë që ende ka pjesëtarë të të dy komuniteteve, edhe pse është e ndarë administrativisht. Sidoqoftë, dallimet në këto përqindje, pjesëmarrësit serbë i shpjeguan me ndryshimet e konsiderueshme në demografinë e Mitrovicës së jugut pas konfliktit. Kështu, deklarojnë se Mitrovica e jugut dhe veriut janë populluar nga shumë banorë të zonave të mëparshme rurale, të cilët nuk kanë pasur shumë kontakte me serbët as në kohën jugosllave dhe se fëmijët e këtyre shtresave të shoqërisë kanë bërë që të kemi dallime në të gjetura.

Përfundimisht, një i intervistuar shqiptar e sheh si burim të këtyre rezultateve raportin "viktimitë-agresor", ndërkohë që një ndjenjë më e fortë e viktimizimit në shoqërinë shqiptare ka krijuar më shumë paragjykime dhe etiketime negative ndaj komunitetit serb. Ky i intervistuar beson se për shkak të kësaj, shqiptarët do të gjykoreshin më shumë nga shoqëria e tyre nëse do të kishin marrëdhënie miqësore me serbët, sesa anasjelltas.

Konkluzion:

Të gjeturat e hulumtimit, si dhe përvoja e autorëve, vënë në pah faktin se komunitetet në Kosovë jetojnë një realitet të fragmentuar që nuk mund të përjetohet plotësisht pa kuptuar gjuhën e komunitetit tjetër. Edhe pse ngjarjet e së kaluarës ndikojnë në masë të madhe në gatishmërinë e të dyja palëve për të pranuar faktin se komuniteti tjetër po formëson dhe realitetin e tyre, kjo nuk do të thotë se ky nuk është fakt.

Për ilustrim, siç thuhet nga një ndër të anketuarit, për të mësuar të vërtetën më të afërt të mundshme rreth asaj që po ndodh në procesin e negociatave në Bruksel, duhet të lexohen deklaratat e dy palëve të negociatave në mediat serbe, dhe deklaratat dhe interpretimet në mediat shqiptare. Vetëm përmes krahasimit të burimeve të ndryshme mund të arrihet tek disa të vërteta.

Kjo nuk do të thotë që të gjitha mediat janë domosdoshmërisht të njëanshme, por pengesa gjuhësore dhe koha e nevojshme për përkthimin e deklaratave në gjuhën tjetër, ngadalësojnë rrjedhën e informacionit kritik. Dhe për shqiptarët e Kosovës dhe për serbët e Kosovës, pavarësisht sa e vështirë mund të jetë t'a pranojnë si fakt, çfarë ndodh në Bruksel ose në një takim të kabinetit të Qeverisë së Kosovës dhe të Serbisë, ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve. Ekzistojnë dy anët e së njëjtës monedhë (në varësi të komunitetit dhe ku ato jetojnë një mund të jetë më e rëndësishme se tjetra) të realitetit në Kosovë dhe ato mund të kuptohen plotësisht vetëm prej atyre që nuk humbasin informacionin e njëres anë.

Hulumtimi gjithashtu tregoi se, edhe pse mbi 40% e të anketuarve nuk janë të gatshëm të mësojnë gjuhën e komunitetit tjetër, pak më shumë se një e treta e të anketuarve ose e dinë ose janë të gatshëm të mësojnë gjuhën tjetër. Këtij grupi dhe atyre të pavendosur rreth kësaj teme (afër 20%) duhet t'u jepet një mundësi e përshtatshme për të vepruar mbi qëllimet e tyre, ndërsa shumëgjuhësia duhet të promovohet si vlerë, si nga OSHC-të ashtu edhe nga institucionet qeveritare në mënyrë që të mënjanohen pjesë nga stigma sociale dhe perceptimi mbizotërues mbi gjuhën si mjet dominimi apo asimilimi. Që të dy, komuniteti shqiptar dhe ai i serb i Kosovës kanë proverba që thonë se "sa më shumë gjuhë që njihni, aq më shumë jeni të vlefshëm" dhe kjo ndjenjë duhet të ushqehet dhe të zbatohet edhe kur është fjala për "gjuhën e armikut".